VENDIM
Nr. 91, datë 6.9.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SNOW ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 45 pika 4, dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f", 5 pika 1 germa "f" dhe 13 dhe 14 pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Snow Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Snow Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9 pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9 pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9 pika 4.9 germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Snow Energy" sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo